



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

15553/1

Shkodër, më 24.10.2019

**Lënda:** Kthim përgjigje

Z.

**KËSHILLËTAR I KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

I nderuar z.

Në vijim të kërkesës Tuaj të protokolluar në Bashkinë Shkodër me prot. nr.17553, datë 15.10.2019, Ju informojmë si vijon:

1. Objekti në rrugën “Kolë Idromeno” është vendosur në kuadër të projektit “Shkodra Tourist Official Brand & Shop”, financuar nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) në partneritet me Bashkinë Shkodër dhe zbatuar nga Mandarina Project, si një ndër tre organizatat e shpallura fituese në kuadër të shpalljes së Thirrjes së I-rë publike për organizatat e shoqërisë civile.

Në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër”, miratuar me VKB nr. 69, datë 30.10.2017 dhe Marrëveshjes Financiare datë 09.08.2018, të lidhur ndërmjet Mandarina Project dhe UNDP për zbatimin e projektit “Shkodra Tourist Official Brand & Shop” në shërbim të Bashkisë Shkodër, me qëllim promovimin e territorit të Bashkisë Shkodër, në veçanti sektorin e turizmit, deri tani janë realizuar disa aktivitete si krijimi i brandit “Shkodra tourist official brand”, dizenjimi i linjës moderne të suvenireve, trajnimi i artizanëve për prodhimin e produkteve me brandin “Shkodra tourist official brand”, projektimin e objektit “ConTemporary”, etj. Faza e fundit ka qënë vendosja e përkohëshme e objektit “ConTemporary”.

Referuar diskutimeve të përbashkëta ka rezultuar e arsyeshme që projekti të nis në zonën pedonale “Kolë Idromeno” për të vazhduar më pas me vendosjen e objektit

**“ConTemporary”, në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë Shkodër, si në qytet ashtu edhe në njësitë e tjera administrative.**

Si i vetmi në llojin e tij në të gjithë Shqipërinë, “Shkodra Tourist Official Brand & Shop” synon të krijojë një imazh unik, identifikues, risi totale në prodhimin e suvenireve, duke sjellë zhvillim të turizmit vendas, angazhim të artizanëve shkodranë, përfshirjen e të rinjve të apasionuar pas dizajnit, duke e shndërruar këtë imazh në një brand të mirënjohur. Prandaj projekti është i destinuar për të vazhduar brez pas brezi sepse qëllimi i tij i vetëm është promovimi i Shkodrës.

***Në këtë kuadër ju informojmë se objekti “ConTemporary” që është vendosur në rrugën “Kolë Idromeno” do të levizë së shpejti në zona të tjera, si në qytet ashtu edhe në njësitë e tjera administrative.***

2. Në lidhje me kërkesën tuaj për kafshët e rrugëve ju informojmë si vijon:

Operatori ekonomik për kryerjen e këtij shërbimi është “BEST FRIENDS“ (PUTRAT SHPK), e regjistruar me rregjistrim fillestar nr CN -244418-09-15, me licensë profesionale të shoqërisë me nr. serial LN -3185-05-05-2017, datë 05.05.2017 lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmartjes, me seli të shoqërisë në Sarreq, Rruga Marin Biçikemi Shkodër me NUIS L57118023A, e përfaqësuar nga përfaqësues ligjor i shoqërisë Znj.Elizabeta Sala.

Bashkia Shkodër nuk ka asnjë vendqëndrim osë stehëz për qentë e rrugës në administrimin e saj. Bashkia Shkodër zbaton metoden e KSVL (Kap – Sterelizo - Vaksino = Lësho), metodë të cilën e ka përdorur me suksës në bashkëpunim edhe me Shoqatën jo Fitimprurëse Austriake (Pro Qen Albania), nën përkujdesjen e grupit vullnetar Animal Needs Me – Shkodër, me mbështetjen e Fondacionit Zvicëran StrayCoco. Strehizat për numrin e qenve të rrugës janë inefektive dhe të kushtueshme. Strehizat shërbejnë vetëm për raste urgjente private.

Përsa i përket problematikës së braktisjes së kafshëve, Bashkia Shkodër periodikisht ka bërë sensibilizimin e popullatës për mosbraktisjen e këtyre kafshëve nga familjarët rezidentë në territorin e saj.

Bashkia Shkodër ka konstatuar që një pjesë e popullatës së shtuar të qenve të rrugës të pamatrikulluar janë të importuar në territorin e Bashkisë Shkodër nga individë dhe persona të papërgjegjshëm nga rrethet e tjera, por nuk ka arritur të identifikojë mënyrën e importimit të këtyre kafshëve dhe për të hartuar më pas një plan masash në varësi të mënyrës së importimit të tyre.

3. Në lidhje me pyetjen e tretë, sa i përket përdorimit të hapësirave të shfrytëzuara nga bizneset në rrugën “Kolë Idromeno”, ju bëjmë me dije se modulet si dhe hapësirat jepen për shfrytëzim në bazë të vendimit nr. 227 dt. 13.09.2016 të Këshillit Kombëtar të

Restaurimeve si dhe marrëveshjes së bashkëpunimit që ka Bashkia Shkodër me Shoqatën BID Shkodër, bazuar ne vendime, marreveshje dhe dokumentacionin si vijon:

- Vendimin nr. 227, dt. 13.09.2016 të KKR;
- Projektin “Plotësim, unifikim dhe arredim urban i rrugës “13 Dhjetori”, “28 Nëntori”, “Kolë Idromeno”;
- Relacion teknik të projektit “Plotësim, unifikim dhe arredim urban i rrugës “13 Dhjetori”, “28 Nëntori”, “Kolë Idromeno”;
- Marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe shoqatës BID Shkodër;
- Kontrata tip e lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në rrugën “Kolë Idromeno”;
- Lista e bizneseve që kanë lidhur kontratë me Bashkinë Shkodër për shfrytëzimin e këtyre moduleve.

Të gjitha dokumentat e listuara më sipër janë të aksesueshme në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër [www.bashkiashkodër.gov.al](http://www.bashkiashkodër.gov.al)

Me respekt,

